



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAVAJË  
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE

Kavajë, më 14.02.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr.3 datë 14.02.2025

**"PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I  
BLLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND NGA FONDI I KUSHTËZUAR  
DHE NGA BUXHETI I BASHKISË KAVAJË, PËR MUAJIN Janar 2025"**

Në mbështetje të Ligjit 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", I ndryshuar; Ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", I ndryshuar ; Ligjit nr.84/2022, datë 24.11.2022 "Për buxhetin e vitit 2023"; Ligjit 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" indryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.68, dt.23.12.2024 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Kavajë për vitin 2025", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.2 dt.24.01.2025 "Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, si dhe për ato, që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor", si dhe referuar relacionit permbledhës, Drejtoria e Shërbimit Social me propozim të kryetarit të Bashkisë, i paraqet Këshillit Bashkiak:


**TË VENDOSI:**

- 1.Miratimin e listës përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për ndihmën ekonomike për muajin **Janar 2025**, sipas listës bashkëlidhur, **Nr. Familjeve 7, fondi 37.185 lekë.**
- 2.Miratimin e listës së familjeve përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% nga buxheti i Bashkisë Kavajë,për muajin **Janar 2025**, sipas listës bashkëlidhur, **Nr.familjeve 86 , fondi 307.855 lekë.**
2. Efektet financiare të këtij vendimi, do të mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale për 6% e sistemit, dhe nga buxheti Bashkisë Kavajë , llogaria "Transferte në buxhetet familjare".
- 3.Ngarkohen Drejtoria e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Shërbimit Social,Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe PAK, dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015,


**Drejtor e burimeve ekonomike**

**Andi ÇURGU**




**Drejtor i Shërbimit Social**

**Xhulja UZUNI**




**Drejtorja e burimeve ligjore**

**Adrian MALAJ**



**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Meri BITURKU**



**KRYETARI**

**Fisnik QOSJA**

